



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 704 Prot.

Tiranë, më 14.04.2026

Lënda: Rekomandim për marrjen e masave për harmonizimin e legjislacionit me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, lidhur me heqjen apo kufizimin e zotësisë për të vepruar, të personit, bazuar në aftësinë e tij të kufizuar mendore, intelektuale.

KUVENDIT TË SHQIPËRISË
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 4, Tiranë

KESHILLIT TË MINISTRAVE
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë

MINISTRISË SË DREJTËSISË
Bulevardi “Zog I – rë”

Për dijeni: FONDACIONIT SHQIPTAR PËR TË DREJTAT E PAK
“Rruga e Bogdanëve”, Nr. 19, Tiranë

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹ është krijuar dhe funksionon në bazë të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar², si institucion i pavarur, i cili siguron mbrojtje efektive nga diskriminimi, si dhe nga çdo formë sjelljeje që e nxit atë.

Bazuar në nenin 32, pika 1, shkronja “f”, të ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar (LMD), përcaktohet se:
“Komisioneri ka kompetencë ... të bëjë rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin”.

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

² Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja “c”, të LMD-së, ku përcaktohet se:

“Komisioneri ka kompetencë të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji”, Komisioneri, në ushtrim të kompetencës që i jep LMD, me Urdhrin nr. 80, datë 17.07.2025³, ka filluar procedurat ndjekjen kryesisht të çështjes së heqjes apo kufizimit të zotësisë për të vepruar, të personit, duke u bazuar në aftësinë e tij të kufizuar mendore, intelektuale.

I. Parashtrimi i fakteve lidhur me problematikën e marrë në shqyrtim.

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (Në vijim referuar me akronimin FSHDPAK), në informacionin e dërguar pranë KMD-së, shprehet se, në kuadër të veprimtarisë së tyre, kanë ardhur në dijeni të një fakti, për të cilin kanë parashtruar si më poshtë vijon:

“Në legjislacionin shqiptar zotësia juridike dhe zotësia për të vepruar janë dy koncepte të ndryshme.

Sipas nenit 1, të Kodit Civil, të ndryshuar, përcaktohet se: “Çdo person fizik gëzon zotësi të plotë e të barabartë për të pasur të drejta e detyrime civile, brenda kufijve të caktuar me ligj.” Kjo zotësi fillon me lindjen e personit gjallë dhe mbaron me vdekjen e tij. Njëkohësisht, në të drejtën civile shqiptare një nga kushtet për të marrë pjesë në marrëdhëniet juridiko-civile është zotësia juridike për të vepruar, dhe pjesë e saj është edhe zotësia procedurale civile për të vepruar si palë në proceset gjyqësore.

Në nenin 6, të Kodit Civil, të ndryshuar, zotësia e plotë për të vepruar fitohet me arritjen e moshës madhore 18 (vjeç), pra personi fiton të drejtën për të fituar të drejta dhe për të marrë përsipër detyrime civile.

Në nenin 10, të Kodit Civil, të ndryshuar, përcaktohet se: “Personit madhor, që për shkak sëmundjeje psiqike ose zhvillimi të metë mendor, është tërësisht ose pjesërisht i pazoti të kujdeset për punët e tij, mund t’i hiqet ose kufizohet zotësia për të kryer veprime juridike me vendim të gjykatës.”

Zotësia për të vepruar mund të hiqet ose kufizohet vetëm përmes një vendimi gjykate. Personave të cilëve iu hiqet zotësia për të vepruar i caktohet në të njëjtin vendim një kujdestar ligjor, por çështjet e kujdestarisë ligjore trajtohen në Kodin e Familjes, të ndryshuar.

³ Urdhër nr. 80, datë 17.07.2025 *“Për fillimin e procedurave për ndjekjen “ex officio” të çështjes së heqjes apo kufizimit të zotësë heqjes apo kufizimit të zotësisë për të vepruar, të personit, duke u bazuar në aftësinë e tij të kufizuar mendore, intelektuale”.*

Kodi i Familjes, i ndryshuar, personat të cilëve iu hiqet zotësia për të veruar, i barazon me të miturit, duke përcaktuar në nenin 308, të tij, që, dispozitat e kujdestarisë për të miturit zbatohen edhe për kujdestarinë e personave, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar.

Edhe në aktet e vlerësimit nga ana e ekspertëve mjeko-ligjorë, personat krahasohen vazhdimisht me të miturit, duke i përcaktuar si “infantilë” ose duke përcaktuar “moshën mendore” të tyre. Për shkak të njohurive të pakta të mjekëve në çështjet ligjore, mund të aplikohen teste të papërshtatshme për heqjen e zotësisë për të vepruar. Teste të tilla mund të tregojnë disa aftësi të kufizuara konjiktive por nuk mund të shërbejnë për të përcaktuar zotësinë për të vepruar, sidomos teste si ato që kanë për bazë përcaktimin e moshës mendore.

Në lidhje me proceduat e ankimit kundër vendimit për heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar, parashikohet që mund të ankohet vetë personi, ai/ajo që ka bërë kërkesën për heqje ose kufizim, si dhe të gjithë personat sipas nenit 382, të Kodit të Procedurës Civile, të ndryshuar⁴ (bashkëshorti, gjinia e afërt, prokurori, si dhe të personave që kanë interes të ligjshëm), pavarësisht nga pjesëmarrja ose jo e tyre në gjykimin e kësaj çështjeje.

Me tej, në nenin 386, të K.Pr.C, parashikohet që dispozitat për heqjen zbatohen edhe për kthimin e zotësisë për të vepruar. Megjithatë, edhe pse parashikohet që vetë personi mund të ankohet për heqjen e zotësisë për të vepruar, neni 91, po këtu, nga ana tjetër parashikon që, personat që nuk kanë zotësi për të vepruar në një gjykim civil, mund të marrin pjesë në gjykim vetëm kur përfaqësohen, sipas dispozitave që rregullojnë zotësinë e tyre, pra përmes kujdestarit ligjor.

Pra, kushti i parë i domosdoshëm për heqjen, apo kufizimin e zotësisë për të vepruar është ekzistenca e një aftësie të kufizuar mendore (pavarësisht se nuk përdoret kjo gjuhë eksplicite) dhe si pasojë e kësaj sëmundjeje, personi është tërësisht ose pjesërisht i pazoti për t’u kujdesur për punët e tij. Shprehja tërësisht apo pjesërisht i pazoti, duket sikur nënkupton përkatësisht heqjen e plotë apo të pjesshme të zotësisë për të vepruar.

Duke analizuar kodet, ligjet, apo dhe praktikën gjyqësore, nuk rezulton që të jenë përcaktuar se cilat “punë” janë ato për të cilat një person do të ishte tërësisht apo pjesërisht i paaftë për t’u kujdesur.

A nënkuptojnë “punët” fusha të caktuara, të drejta e detyrime të përcaktuara? A mund të jetë personi tërësisht i pazoti për t’u kujdesur për të gjitha punët e tij? Çfarë do të thotë pjesërisht i pazoti për t’u kujdesur për punët? Kjo do të kërkonte një kategorizim të “punëve” të personit por edhe një sistem vlerësimi të atillë, që përcakton domethënien e “tërësisht i pazoti” ose “pjesërisht i pazoti”.

Nëse do të ekzistonte një vlerësim i tillë, ai do të hidhej poshtë tërësisht nga qëndrimi i Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Sipas tij, në Komentin e Përgjithshëm mbi nenin 12, të KDPAK, asnjë nga këto vlerësime nuk është i lejueshëm sipas nenit 12, të KDPAK. Nuk ka teste, apo vlerësime të cilat do të eksploronin mendjen njerëzore dhe për më tepër në të gjitha fushat

⁴ Në vijim referuar edhe me akronimin K.Pr.C

e jetës, pra, teste të cilat do të përcaktonin, në cilën fushë një person do të ishte tërësisht i zoti apo pjesërisht i zoti për t'u kujdesur për punët e tij.

Aktualisht, në Shqipëri nuk ka kritere mjekësore të veçanta të përcaktuara, të cilat do të aplikoheshin për vlerësimin e kapacitetit ligjor (gjuha e KDPAK), ose zotësisë për të vepruar. Nga ekspertiza mjeko-ligjore përdoret testi i inteligjencës, Wechsler IQ Test, i cili është i vetmi i standardizuar. Në Shqipëri mungon një përcaktim për ushtrimin e disa të drejtave dhe mungon lidhja mes pamundësisë së ushtrimit të zotësisë juridike me aftësiën mendore që ka personi. Përcaktimi absolut: personi , ose ka, ose nuk ka zotësinë për të vepruar. Personi me aftësi të kufizuara mendore, si i tillë, nëse nuk kalon testin e inteligjencës dhe intervistën klinike, nuk ka zotësi për të vepruar në asnjë fushë të jetës. Në lidhje me këtë, duhet pasur në vëmendje jurisprudenca e GJEDNJ-së, e cila është shprehur se, gjykata duhet të marrë në konsideratë ekspertizën e dhënë, së bashku me faktorë të tjerë të jetës së personit, marrëdhëniet e tij me të tjerë, mundësitë praktike, përtej diagnozës. Është e qartë, duke u bazuar në arsyetimin e mësipërm e në Komentin e Përgjithshëm, që, pamundësia për të ushtruar një të drejtë nuk mund të nënkuptojë pamundësi për të ushtruar të drejtë të tjera. Për shembull, pamundësia për të dhënë miratimin për një procedurë mjekësore, nuk nënkupton edhe pamundësi për të bërë një deklaratë apo një marrëveshje. Aftësia për të marrë një vendim varet nga kompleksiteti i çështjes.

Në lidhje me ekzistencën e mundësisë për heqjen e pjesshme të zotësisë për të vepruar, duhet theksuar që efektet në praktikë të heqjes së plotë, ose vetëm të kufizimit, nuk kanë ndryshime mes tyre dhe nuk janë të qarta. Kjo vjen si pasojë e mospërcaktimit të kufizimit të pjesshëm, fushave të kufizimit.

Rastet e heqjes së pjesshme janë shumë të rralla, dhe ka një interpretim të këtij kufizimi të kuptuar si kufizim në kohë, dhe jo në fusha veprimi.

Pra, është konsideruar kufizimi i zotësisë për të vepruar në terma kohorë. Ky lloj kufizimi ka ardhur si pasojë e marrjes në konsideratë nga ana e gjykatës, e një mundësie në të ardhmen për përmirësimin e gjendjes shëndetësore nga mjekët.

Megjithatë, duke lexuar dispozitat ligjore, në interpretimin tonë, arrihet në përfundimin që kufizimi i zotësisë për të vepruar nuk nënkupton kufizimin në kohë, por në fusha, apo për veprime të caktuara juridike. Në asnjë rast, në ligjet në shqyrtim, nuk gjenden dispozita të cilat adresojnë vullnetin apo dëshirat e personit. Madje, në dispozitat përkatëse gjejmë të reflektuar qasjen mjekësore, në bazë të së cilës është qartësisht i orientuar i gjithë procesi i heqjes ose kufizimit të zotësisë për të vepruar. Duhet shtuar që kjo është një qasje, e cila reflektohet gjerësisht në të gjitha fushat ku trajtohen dhe ndërveprohet me personat me aftësi të kufizuara, sidomos aftësi të kufizuara mendore.

Modeli social i propozuar nga KDPAK, nuk gjen zbatim akoma në legjislacionin tonë.

Njohja e barabartë para ligjit, e parë si koncept që përfshin si element integral dhe zotësinë për të vepruar, lidhet ngushtë me zbatimin e këtij modeli. Sipas tij, shqëria, duke përfshirë institucionet publike, e cila përjashton, përmes barrierave personat me aftësi të kufizuara dhe në këtë rast, një proces i paragjykuar, në të cilin merren parasysh vetëm elementët mjekësore, dhe nuk ka përpjekje për të kuptuar aftësinë e personit, përbën barrierën kryesore e cila është edhe shkak dhe pasojë njëkohësisht.

Për t'u ndërlidhur me mungesën e adresimit në ligjet tona të shprehjes së vullnetit të personit me aftësi të kufizuara në raport me ushtrimin e zotësisë juridike, ose kapaciteti ligjor (sipas terminologjisë së KDPAK), i drejtohem figurës së kujdestarit ligjor, i cili vepron në emër të personit.

K. Pr. C, në nenin 91, të tij, përcakton që, personat që nuk kanë zotësi për të vepruar në një gjykim civil, mund të marrin pjesë në gjykim, vetëm kur përfaqësohen sipas dispozitave që rregullojnë zotësinë e tyre për të vepruar.

Kujdestari përfaqëson dhe administron pasurinë e personit të cilit i është hequr zotësia për të vepruar, ashtu si prindi përfaqëson dhe administron pasurinë e të miturit që nuk ka mbushur 14 vjeç. Në lidhje me figurën e kujdestarit ligjor, Kodi i Familjes, i ndryshuar, përcakton disa kushte që nuk lejojnë vendosjen si kujdestar.

Regjistri i kujdestarëve nuk është funksional. Nuk ka një shifër të personave me aftësi të kufizuara të vendosur në kujdestari ligjore, mungesë e cila mund të çojë edhe në mungesën e mbikëqyrjes së punës së tyre.

FSHPAK, lidhur me këtë problematikë, vlerëson se, heqja apo kufizimi i zotësisë për të vepruar, i personave me aftësi të kufizuara është një shkelje e rëndë e të drejtave të tyre të mbrojtura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar dhe Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e PAK”. Me ratifikimin e kësaj Konvente, shteti shqiptar ka marrë përsipër afrimin e një mbrojtjeje maksimale të të drejtave të PAK, në përmbushje të detyrimeve që përcaktohen në të.

Heqja e zotësisë juridike ose kufizimi i tyre përbën një formë diskriminimi të bazuar në aftësinë e kufizuar kur ajo iu hiqet personave me aftësi të kufizuara mbi bazën prima facia të AK ose kur procedura zbatohet në mënyrë disproporcionale për PAK.

Legjislacioni shqiptar kërkon që personi të ketë një sëmundje psikike ose zhvillim të metë (terminologji kjo që në vetvete është e papërshtatshme, e cila nxit një model mjekësor dhe përbën fyerje apo paragjykim), pra në rastet më të shumta që të jetë një person me aftësi të kufizuar-kjo përbën një trajtim diferencial prima facia, në bazë të aftësisë së kufizuar.

Edhe pse institucioni i kujdestarisë (që derivon nga heqja e zotësisë për të vepruar) ka lindur si mekanizëm mbrojtës për PAK, heqja e zotësisë për të vepruar parandalon personat me aftësi të kufizuara nga ushtrimi i të drejtave të tyre, ndërsa personat pa aftësi të kufizuara në situata të ngjashme nuk i nënshtrohen ndërhyrjeve të tilla.

...

Sa më sipër, kërkojmë hartimin e rekomandimeve për ndryshimin e legjislacionit shqiptar, me qëllim eliminimin e diskriminimit për persoant me aftësi të kufizuar intelektuale...”

II. Legjislacioni i zbatueshëm

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 15

1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik.
2. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

Neni 16

1. Të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejnë njëlloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara.

Neni 17

1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.
2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Neni 18

1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.
2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.
3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive.

Neni 122

1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Ndryshimi, plotësimi dhe shfuqizimi i ligjeve të miratuara me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për efekt të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet me të njëjtën shumicë.
2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.
3. Normat e nxjerra prej një organizate ndërkombëtare kanë epërsi, në rast konflikti, mbi të drejtën e vendit, kur në marrëveshjen e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për pjesëmarrjen në atë organizatë, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i normave të nxjerra prej asaj.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut

Neni 2

Secili gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë Deklaratë pa kurrfarë kufizimesh përsa i përket racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit fetar, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes ose tjetër.

Neni 7

Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë diskriminim të mbrohen barabar nga ligji. Të gjithë kanë të drejtën për t'u mbrojtur barabar kundër çdo diskriminimi që cënon këtë Deklaratë, si dhe kundër çdo nxitje për një diskriminim të tillë.

Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut⁵ (KEDNJ)

Neni 14

“Ndalimi i diskriminimit”

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si: seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindaj ose çdo status tjetër.

Protokolli 12, KEDNJ

Neni 1

“Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit”

1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si: seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.
2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar⁶

Neni 1

“Qëllimi”

Qëllimi i kësaj Konvente është të nxisë, mbrojë dhe të sigurohet që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre.

Personat me aftësi të kufizuar përfshijnë individët me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore aftagjata të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë.

⁵ Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996.

⁶ Shqipëria e ratifikoi KDPAK në Dhjetor të vitit 2012 dhe është bërë Palë në të që prej 11 Shkurtit 2013.

Neni 2

“Përkufizimet”

Në kuptimin të kësaj Konvente:

“Diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar” ka kuptimin e çdo dallimi, përjashtimi apo kufizimi për shkak të aftësisë së kufizuar, që ka si qëllim ose ndikon në pengimin apo mohimin e njohjes, gëzimit apo ushtrimit, njësoj si gjithë të tjerët, të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile apo në ndonjë fushë tjetër. Në këtë përkufizim përfshihen të gjitha format e diskriminimit, duke përfshirë edhe mohimin e përshtatjes brenda logjikës”.

Neni 3

“Parime të përgjithshme”

Parimet e kësaj Konvente do të përfshijnë:

- (a) Respektin për dinjitetin, autonominë individuale përfshirë lirinë për të bërë zgjedhjet personale, dhe pavarësinë e personit;
- (b) Mosdiskriminimin;
- (c) Pjesëmarrjen dhe përfshirjen e plotë dhe efektive në shoqëri;
-
- (e) mundësi të barabarta;
- (f) Akses;

Neni 4

“Detyrime të përgjithshme”

1. Shtetet Palë marrin përsipër të sigurojnë dhe nxisin realizimin e plotë të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut për të gjithë personat me aftësi të kufizuar, pa diskriminim të ndonjë lloji për shkak të aftësisë së kufizuar. Për këtë qëllim, Shtetet Palë marrin përsipër:

- (a) Të miratojnë të gjitha masat e duhura legjislative dhe administrative, si dhe masa të tjera për zbatimin e të drejtave të njohura nga kjo Konventë;
- (b) Të marrin të gjitha masat e duhura, duke përfshirë ato legjislative për të modifikuar apo shfuqizuar ligjet, rregulloret, zakonet dhe praktikatat ekzistuese, të cilat kanë përmbajtje diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuar;
- (c) Të marrin parasysh mbrojtjen dhe nxitjen e të drejtave të njeriut për personat me aftësi të kufizuar në të gjitha politikatat dhe programet;
- (d) Të mos marrin pjesë në veprime apo praktika që nuk janë në përputhje me këtë Konventë dhe të sigurohen që autoritetet dhe institucionet publike veprojnë në përputhje me këtë Konventë;
- (e) Të marrin të gjitha masat e duhura...

3. Në zhvillimin dhe zbatimin e legjislacionit për zbatimin e kësaj Konvente, si dhe për proceset e tjera vendim-marrëse në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me personat me aftësi të kufizuar. Shtetet Palë duhet të konsultohen në mënyrë aktive me personat me aftësi të kufizuar, përfshirë këtu edhe fëmijët me aftësi të kufizuar për të siguruar përfshirjen e tyre nëpërmjet organizatave të tyre përfaqësuese.

4. Asgjë nga kjo Konventë nuk duhet të prekë ato dispozita, që janë më të favorshme për realizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar dhe që mund të përmbahen në ligjin e Shtetit Palë apo ligjin ndërkombëtar në fuqi për atë Shtet. Nuk duhet të ketë asnjë kufizim apo cënim të asnjë prej të drejtave të njeriut dhe lirive themeltare të njohura apo ekzistuese në cilindo Shtet Palë në këtë Konventë në përputhje me ligjin, konventat, rregulloret apo zakonet me pretekstin se kjo Konventë nuk i njeh këto të drejta apo liri, apo se ajo i njeh ato në një masë më të vogël.

Neni 5

“Barazia dhe mosdiskriminimi”

1. Shtetet Palë pranojnë se të gjithë personat janë të barabartë përpara ligjit dhe se gëzojnë të drejtë pa asnjë diskriminim për mbrojtje të barabartë dhe përfitim të barabartë nga ligji.

2. Shtetet Palë duhet të ndalojnë çdo lloj diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar dhe t’u garantojnë personave me aftësi të kufizuar mbrojtje ligjore të barabartë dhe efektive ndaj çdo lloj diskriminimi dhe në cdo rrethanë.

.....

4. Masat specifike të cilat janë të nevojshme për të përshpejtuar apo arritur *de facto* barazinë e personave me aftësi të kufizuar nuk do të konsiderohen diskriminim sipas termave të kësaj Konvente.

Neni 12

“Njohja e barabartë para ligjit”

1. Shtetet Palë riafirmojnë se personat me aftësi të kufizuar kanë të drejtën e njohjes kudo si persona përpara ligjit.

2. Shtetet Palë pranojnë që personat me aftësi të kufizuar gëzojnë kapacitetin ligjor njësoj si pjesa tjetër e popullsisë në të gjitha aspektet e jetës.

3. Shtetet Palë do të marrin masat e duhura për tu siguruar personave me aftësi të kufizuar akses në lidhje me mbështetjen që ata mund të kërkojnë në ushtrimin e kapacitetit të tyre ligjor.

4. Shtetet Palë në përputhje me ligjet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut do të sigurohen që të gjitha masat që lidhen me ushtrimin e kapacitetit ligjor përmbajnë standarde të përshtatshme dhe efikase për të parandaluar abuzimin, këto standarde do të bëjnë të mundur që masat që lidhen me ushtrimin e kapacitetit ligjor respektojnë të drejtat, vullnetin dhe preferencat e personit nuk kanë konflikt interesi dhe ndikim të panevojshëm, janë në propocion dhe të përshtatura sipas rrethanave të personit, aplikohen për periudhën më të shkurtër të mundshme dhe u nënshtrohen shqyrtimeve të rregullta nga një autoriteti kompetent, i pavarur dhe i paanshëm apo një trupe gjyqësore. Standardet do të jenë proporcionale më masën që këto masa cenojnë të drejtat dhe interesat e personit

5. Në varësi të dispozitave të këtij neni, Shtetet palë do të marrin të gjitha masat e duhura dhe efektive për të siguruar të drejtën e barabartë e personave me aftësi të kufizuar për të patur në pronësi apo për të trashëguar prona, për të kontrolluar çështjet e tyre financiare dhe për të pasur akses të barabartë në kreditë bankare, hipoteka dhe forma të tjera të kredive financiare dhe do të sigurohet që personave me aftësi të kufizuar nuk iu hiqet në mënyrë arbitrare prona.

Kodi Civil, i ndryshuar

Neni 9

“I mituri me moshë katërbëdhjetë vjeç deri në tetëmbëdhjetë vjeç, i cili është i pazoti të kujdeset për punën e tij për shkak sëmundjesh psikike ose zhvillimi të metë mendor, mund t’i hiqet zotësia për të kryer veprime juridike me vendim të gjykatës. Këto veprime mund të kryhen vetëm nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor.”

Neni 10

“Personit madhor, që për shkak sëmundjeje psikike ose zhvillimi të metë mendor, është tërësisht ose pjesërisht i pazoti të kujdeset për punët e tij, mund t’i hiqet ose kufizohet zotësia për të kryer veprime juridike me vendim të gjykatës.”

Neni 13

I mituri që nuk ka mbushur moshën katërbëdhjetë vjeç, ka për banim atë të prindërve të tij. Kur prindërit kanë banime të ndryshme, fëmija e tyre nën katërbëdhjetë vjeç ka për banim atë të prindit pranë të cilit jeton. Personi të cilit i është hequr zotësia për të vepruar dhe fëmijët nën kujdestari kanë për banim atë të përfaqësuesit të tyre ligjor.

Neni 64

Kuptimi i përfaqësimit

“Me përfaqësimin një person (përfaqësuesi) kryen, brenda tagreve që i janë dhënë nga ligji, nga prokura ose nga gjykata, veprime juridike në emër e për llogari të një personi fizik ose juridik tjetër (i përfaqësuar). Përfaqësimi nuk lejohet kur veprimi juridik duhet, sipas ligjit, të kryhet nga vetë personi. Nuk mund të veprojë si përfaqësues personi që nuk ka zotësi të plotë për të vepruar.”

Neni 76

Mbarimi i prokurës

“Prokura mbaron kur: ... c) ka vdekur përfaqësuesi apo i përfaqësuar, ose kur njëri prej tyre ka humbur zotësinë për të vepruar.”

Neni 82

Personi që nuk di, ose që për shkak sëmundje ose të metash fizike nuk mund të nënshkruajë, ngarkon një person tjetër për këtë qëllim. Nënshkrimi i këtij personi duhet të vërtetohet nga noteri, duke u treguar shkaku për të cilin personi që ka kryer veprimin juridik nuk ka mundur ta nënshkruajë vetë. Për veprimet që kryhen në bankat dhe në institucionet e tjera të kreditit, në zyrat postare apo doganore, nënshkrimi i këtij personi vërtetohet nga një nëpunës i autorizuar i këtyre institucioneve.

Neni 94

Veprime juridike që shpallen të pavlefshme

Të anulueshme quhen veprimet juridike të cilat janë të vlefshme gjersa gjykata me kërkesën e të interesuarit i shpall të pavlefshme. Të tilla janë veprimet juridike të kryera nga:...b) personat, të cilët për shkak sëmundje psikike ose zhvillimi të metë mendor u është hequr ose kufizuar zotësia

për të vepruar, kur veprimin juridik e kanë kryer pa pëlqimin e kujdestarit; c) personat, të cilët në kohën e kryerjes së veprimit juridik nuk ishin të ndërgjegjshëm për rëndësinë e veprimeve të tyre, megjithëse në atë kohë nuk u ishte hequr zotësia për të vepruar; ç) personi që ka kryer veprimin juridik duke qenë i mashtruar, i kanosur, në lajthim ose për shkak të nevojës së madhe. Anulimi i këtyre veprimeve mund të kërkohej edhe pas vdekjes së personit përkatës, por vetëm kur para vdekjes është kërkuar heqja e zotësisë së tij për të vepruar

Neni 104

Afati për ngritjen e padisë fillon:

a) për veprime juridike të kryera nga persona që u është hequr ose kanë patur zotësi juridike të kufizuar...

Neni 108

Kur veprimi juridik konstatohet se është i pavlefshëm për arsye se është kryer nga një i mitur, që nuk ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç ose shpallet i pavlefshëm se është kryer nga një i mitur që ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç, por pa pëlqimin e prindit ose të kujdestarit të tij, secila nga palët detyrohet t'i kthejë palës tjetër çdo gjë që ka marrë prej saj dhe kur nuk është e mundur të kthejë po atë gjë, t'i paguajë vleftën. Përveç kësaj, pala që ka zotësi për të vepruar detyrohet t'i shpërblejë të miturit dëmin që ky ka pësuar për shkak se veprimi juridik konstatohet ose shpallet i pavlefshëm.

Neni 109

Kur veprimi juridik shpallet i pavlefshëm për arsye se është kryer nga një person, të cilit i është hequr krejt zotësia për të vepruar ose për arsye se është kryer nga një person të cilit i është kufizuar zotësia për të vepruar e pa patur pëlqimin e kujdestarit të tij, ose për arsye se është kryer nga një person i cili në kohën e kryerjes së veprimit juridik nuk ka patur ndërgjegjen e rëndësisë së veprimeve të tij, secila nga palët detyrohet t'i kthejë palës tjetër çdo gjë që ka marrë prej saj dhe, kur nuk është e mundur t'i kthejë po atë gjë, t'i paguajë vleftën. Përveç kësaj, pala që ka patur zotësinë për të vepruar detyrohet t'i shpërblejë palës tjetër dëmin që kjo palë ka pësuar për shkak të veprimit juridik që është shpallur i pavlefshëm, në rast se dinte ose duhet të dinte se pala tjetër nuk ka patur zotësi për të vepruar ose nuk ka patur ndërgjegjen e rëndësisë së veprimeve të saj.

Neni 129

Pezullimi i parashkrimit

Parashkrimi pezullohet:

....

c) midis personave që ndodhen nën kujdestari dhe kujdestarëve të tyre gjersa vazhdon kujdestaria;

....

d) për paditë e të miturve dhe personave të tjerë, që nuk kanë zotësi për të vepruar gjersa t'u emërohet përfaqësuesi ose të fitojnë këtë zotësi, si edhe për gjashtë muaj pasi është emëruar përfaqësuesi ose pasi kanë fituar zotësinë për të vepruar;

Neni 373

Zotësia për të disponuar me testament

Testament mund të bëjë çdo person që ka mbushur moshën 18 vjeç, si dhe gruaja nën këtë moshë kur është e martuar. I mituri nga 14 gjer në 18 vjeç mund të bëjë testament vetëm për pasurinë që ka fituar me punën e tij. Personi të cilit me vendim gjyqi i është hequr zotësia për të vepruar, si dhe ai që në kohën e bërjes së testamentit nuk është në gjendje për të kuptuar rëndësinë e veprimit të tij, nuk mund të bëjë testament.

Kodi i Procedurës Civile, i ndryshuar

Neni 33

“... Nuk mund të ngrihet padi nga një person që i mungon zotësia juridike për të vepruar.”

Neni 35/ç

Paditë për heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar të personave.

Neni 44

Paditë kundër ... personave që u është hequr krejtësisht zotësia...

Neni 91

Zotësia për të vepruar

Kanë zotësi për të vepruar në një gjykim civil personat që ushtrojnë lirisht të drejtat, të cilat duhet të respektohen nga të tjerët. Personat, që nuk kanë zotësi për të vepruar në një gjykim civil, mund të marrin pjesë në gjykim vetëm kur përfaqësohen, sipas dispozitave që rregullojnë zotësinë e tyre.

Neni 131

“... përveç kur marrësi është ... i pazoti për të vepruar ...”

Neni 158/a

“... ose palëve u mungon zotësia për të vepruar ...”

Neni 235

“Nuk mund të pyeten si dëshmitarë: ... personat që për shkak të metash fizike ose psikike...”

Nenet 297, 298

“... pala ka humbur zotësinë juridike për të vepruar...”

Kodi i Familjes, i ndryshuar

Neni 6

Aktgjykimi i deklarimit të pavlefshmërisë së martesës

Martesa është e pavlefshme kur njëri nga bashkëshortët... ka qenë i paaftë për të vepruar për shkak të një sëmundjeje të rëndë psikike.

Neni 10

Pengesat për lidhjen e martesës

Nuk lejohet lidhja e martesës me një person që është i paaftë për të vepruar për shkak të një sëmundjeje të rëndë psikike.

Neni 47

Kur bashkëshortit i është hequr zotësia për të vepruar, padia për pavlefshmërinë e martesës mund të ngrihet nga kujdestari i tij.

Neni 184

Heqja e të drejtës për të ushtruar përgjegjësitë prindërore

...Kur prindi shpallet i paaftë për të vepruar për shkak të një sëmundjeje mendore...

Neni 222

Vendosja nën kujdestari

Personi i shpallur i paaftë për të vepruar, për shkak të një sëmundjeje të rëndë psikike... vendoset nën kujdestari.

...

Kodi Penal, i ndryshuar

Neni 17

Papërgjegjshmëria për shkak të gjendjes mendore

Nuk ka përgjegjësi penale, personi që, për shkak të sëmundjes mendore ose paaftësisë mendore, në kohën e kryerjes së veprës penale nuk ka qenë në gjendje të kuptojë ose të kontrollojë veprimet e veta.

Neni 46

Masat e detyrueshme mjekësore

Personit që ka kryer vepër penale në gjendje paaftësie mendore ose paaftësie të kufizuar mendore mund t'i vendosen masat e detyrueshme të mjekimit në institucion psikiatrik ose në kushte ambulatorë.

Neni 48

Masat mjekësore gjatë vuajtjes së dënimit

Kur gjatë vuajtjes së dënimit konstatohet gjendja e paaftësisë mendore, personit i vendoset masa e detyrueshme e mjekimit në institucion psikiatrik.

Kodi i Procedurës Penale, i ndryshuar

Neni 43

Kur gjatë hetimeve ose gjykimit lind dyshimi mbi gjendjen mendore të pandehurit, gjykata urdhëron ekspertim psikiatrik për të përcaktuar nëse ai është në gjendje të marrë pjesë me vetëdije në proces.

Neni 44

Kur gjendja mendore e të pandehurit e bën të pamundur pjesëmarrjen e tij në proces, gjykata urdhëron pezullimin e procedimit.

Neni 46

Gjykata mund të urdhërojë masa mjekësore të detyrueshme për të pandehurin që për shkak të gjendjes mendore është i papërgjegjshëm ose pjesërisht i papërgjegjshëm.

Neni 47

Kur pas kryerjes së veprës penale gjendja mendore e të pandehurit ndryshon, gjykata mund të vendosë pezullimin e procesit dhe trajtimin e detyruar.

Neni 49

Kur i pandehuri është i paaftë për të vepruar, ai përfaqësohet nga kujdestari ose përfaqësuesi i tij ligjor.

Neni 58

Pjesëmarrja e të pandehurit në gjykim është e detyrueshme, përveç rasteve kur ai është i sëmurë ose i paaftë.

Neni 59

Kur i pandehuri është i paaftë, ai përfaqësohet nga një përfaqësues i detyruar.

Neni 155

Nuk mund të dëshmojnë personat që, për shkak të gjendjes mendore ose zhvillimit mendor, nuk janë në gjendje të perceptojnë ose të tregojnë fakte.

Neni 156

Gjykata vlerëson aftësinë e dëshmitarit kur ajo është e dyshimtë për shkak të gjendjes mendore.

Neni 350

Gjykata mund të urdhërojë ekspertizë mjekësore për të përcaktuar përgjegjësinë ose gjendjen mendore të të pandehurit.

Neni 383

Ekzekutimi i masave mjekësore të detyrueshme bëhet sipas vendimit të gjykatës.

Neni 384

Gjykata përcakton institucionin ku do të kryhet masa mjekësore e detyrueshme.

Në frymën e Konventës, është miratuar, **ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”**, i cili ka si qëllim, të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes; të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre, të barabartë në shoqëri.

Persona me aftësi të kufizuara, sipas këtij ligji, janë, individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët.

Jetesa e pavarur, u siguron personave me aftësi të kufizuara zgjedhje, kontroll dhe liri të njëjta me të tjerët. Në shkronjën “ë”, të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 93/2014, parashikohet se: “*Politikat shtetërore mbështetin personat me aftësi të kufizuara që të kenë akses në të gjitha sferat e jetës...*”

Sipas nenit 6, të ligjit nr. 93/2014, jetesa e pavarur, mundësohet nëpërmjet shërbimeve të ndryshme që synojnë të ofrojnë mbështetje në kapërcimin e barrierave.

Në neni 7 - Vendimmarrja e mbështetur – përcaktohet se:

1. “Vendimmarrje e mbështetur” është ushtrimi i vullnetit nga një person me aftësi të kufizuara nëpërmjet një kompetence specifike të shtuar, që mbështet qëllimin dhe interesin e tij më të mirë, duke i mundësuar kryerjen e veprimeve për të fituar të drejta dhe për të marrë përsipër detyrime.
2. Çdo person me aftësi të kufizuara, që ka nevojë për ndihmë në vendimmarrje, merr mbështetjen e duhur nga një individ ose grup individësh të besuar. Mbështetja mund të sigurohet në një sërë mënyrash, përfshirë mbështetjen me anë të interpretimit dhe gjuhës së thjeshtë, si dhe ndihmën në marrëdhëniet e personit me palë të treta, që nuk mund të kuptojnë mënyrat e tij të komunikimit. Mbështetja jepet gradualisht, duke u dhënë kohë të mjaftueshme personave që e kërkojnë atë, për të mësuar se si mund ta përdorin mbështetjen për më të mirën e tyre.
3. Rregullat, procedurat dhe kriteret e ofrimit të këtyre shërbimeve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU II - VLERËSIMI I AFTËSISË SË KUFIZUAR DHE NEVOJAVE PËR NDIHMË E MBËSHTETJE

Neni 10

Komisioni për vlerësimin e aftësisë së kufizuar dhe nevojave për ndihmë e mbështetje

1. Vlerësimi i aftësisë së kufizuar realizohet nga komisionet multidisiplinare. Komisionet bëjnë vlerësimin e gjendjes së aftësisë së kufizuar, nevojave për shërbime, mjete dhe përkujdesje, me

synimin për të minimizuar pengesat e përfshirjes dhe për të rritur në maksimum autonominë dhe jetesën e pavarur për personat me aftësi të kufizuara.

2. Komisionet multidisiplinare për vlerësimin e aftësisë së kufizuar e të nevojave për ndihmë e mbështetje ngrihen dhe administrohen nga ministria përgjegjëse për çështjet e aftësisë së kufizuar.

3. Komisionet janë të pavarura në vlerësimin dhe në punën e tyre. Ky vlerësim bëhet bazuar në Klasi-fikimin Ndërkombëtar për Funksionimin, Aftësitë e Kufizuara dhe Shëndetin (ICF) të Organizatës Botërore të Shëndetit...

Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar

Neni 1

“Objekti”

Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër

Neni 2

“Qëllimi”

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për:

- a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji;
- b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike;
- c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

Neni 3

“Përkufizimet”

“*Diskriminim*” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

9. “*Mohim i një përshtatjeje të arsyeshme*” është ajo formë diskriminimi që ndodh kurdoherë kur ka një mohim ose kundërshtim për të kryer ndryshime ose rregullime të domosdoshme e të përshtatshme, që nevojiten në një rast të veçantë dhe nuk imponojnë një barrë të tepruar, me qëllim që të sigurohet gëzimi dhe ushtrimi në baza të barabarta i të drejtave dhe lirive themelore, të njohura në kuadrin ligjor kombëtar, për personat me aftësi të kufizuara, ose të ndodhur në kushtet e tjera të përmendura në nenin 1 të këtij ligji.

Neni 20

“Të mirat dhe shërbimet”

1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohej të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun;

Neni 22

“Statusi”

Komisioneri është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe u nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjit.

Neni 32

“Kompetencat”

1. Komisioneri ka kompetencë:

...c) të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji;

...ë) t’u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues;

III. Arsyetimi ligjor

Në përfundim të analizës së legjislacionit, rezultoi se:

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK) është pjesë e së drejtës ndërkombëtare që garanton pikërisht këto të drejta dhe që ka udhëhequr proceset e transformimeve në mbarë botën tashmë. Në qendër të kësaj konvente dhe risive që ajo ka arritur të konkretizojë qëndrojnë dy të drejta themelore: njohja e barabartë para ligjit dhe e drejta për akses të barabartë në drejtësi. Këto të drejta kërkojnë që personat me aftësi të kufizuara të trajtohen si subjekte të barabarta juridike, me të drejtën për të marrë vendime për jetën e tyre dhe për të jetuar në mënyrë të pavarur, me mbështetjen e nevojshme.

Njohja e barabartë para ligjit është themeli i garantimit të të drejtave dhe lirive themelore, pasi siguron që çdo person, përfshirë edhe personat me aftësi të kufizuara, të gëzojë të njëjtat të drejta dhe detyrime juridike pa diskriminim dhe me respekt të plotë për dinjitetin e tij. Kjo e drejtë nënkupton që personat me aftësi të kufizuara, pavarësisht llojit apo shkallës së aftësisë së kufizuar

që ata kanë, gëzojnë në çdo kohë zotësinë juridike për të vepruar dhe marrin mbështetjen e nevojshme për t'a ushtruar atë sipas vullnetit dhe preferencave që ata kanë.

Akresi në drejtësi për personat me aftësi të kufizuara është themelor sepse garanton ushtrimin efektiv të të gjitha të drejtave të tjera, duke u mundësuar atyre mbrojtje efektive, pjesëmarrje të barabartë në proceset gjyqësore dhe sigurimin e një shoqërie pa diskriminim.

Në kontekstin shqiptar, legjislacioni aktual sipërcituar, ende përmban dispozita që kufizojnë zotësinë juridike për të vepruar të individëve përmes sistemit të kujdestarisë ligjore, duke i privuar ata nga e drejta për të vendosur vetë për çështje personale, ekonomike apo shëndetësore. Kjo qasje, e mbështetur në modele të vjetra, bie ndesh pikërisht me standardet moderne të të drejtave të njeriut dhe KDPAK në veçanti, të cilat promovojnë mbështetjen në vendimmarrje dhe fuqizimin e individit.

Ndryshimet ligjore të nevojshme përfshijnë heqjen e dispozitave që kufizojnë zotësinë juridike për të vepruar në bazë të aftësisë së kufizuar, si dhe krijimin e mekanizmave për mbështetje në vendimmarrje. Po ashtu, është e rëndësishme të zhvillohen shërbime komunitare që mundësojnë jetesën e pavarur, duke garantuar akses në strehim, arsim, punësim dhe shërbime sociale duke theksuar që reformat ligjore janë ngushtësisht të lidhura dhe të ndërruara me realizimin e të drejtave të tjera.

Kjo qasje ligjore nuk synon vetëm përputhjen me standardet ndërkombëtare, por edhe ndërtimin e një sistemi që respekton dinjitetin, autonominë dhe barazinë e çdo individi. Vetëm përmes një reforme të thellë ligjore personat me aftësi të kufizuara mund të njihen në mënyrë të barabartë me të tjerët para ligjit duke ruajtur zotësinë e tyre për të vepruar në çdo rast dhe duke marrë mbështetjen e nevojshme për të marrë vendime që njihen para ligjit dhe institucioneve publike apo private, pra që kanë fuqi juridike.

Me ratifikimin e KDPAK nevoja për ndërhyrje ligjore në legjislacionin kombëtar me qëllim përqasjen e legjislacionit me standardet e kësaj konvente u bë më emergjente. Shteti shqiptar dukshëm ka bërë një sërë përpjekjesh për hartimin e një baze ligjore e cila garanton respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe në mënyrë të veçantë nenet 12 dhe 13 të KDPAK. Edhe pse nuk është objektiv i këtij raporti që të sqarojë nenet 12 dhe 13 të KDPAK, në mënyrë të përmblodhur këto nene parashikojnë:

Neni 12 i KDPAK është shtylla themelore e njohjes së personave me aftësi të kufizuara si subjekte të barabarta të së drejtës. Ky nen garanton se çdo person gëzon zotësi juridike në kushte të barabarta me të tjerët dhe se shtetet kanë detyrimin të krijojnë mekanizma mbështetëse për ushtrimin e kësaj zotësie, duke respektuar gjithmonë vullnetin dhe preferencat e individit. Komiteti i KDPAK, përmes Komentit të Përgjithshëm nr. 1, e ka bërë të qartë se sistemet e kujdestarisë ligjore, që heqin ose kufizojnë zotësinë për të vepruar për shkak të aftësisë së kufizuar, bien ndesh me Konventën dhe duhet të zëvendësohen me sisteme të vendimmarrjes së mbështetur. Në praktikë, kjo nënkupton

që asnjë person nuk duhet të përjashtohet nga e drejta për të marrë vendime mbi jetën, pasurinë, marrëdhëniet familjare apo pjesëmarrjen në gjykata, vetëm për shkak të një gjendjeje shëndetësore apo diagnoze. Përkundrazi, shteti duhet të sigurojë mbështetje si përmes mbështetësve të zgjedhur nga vetë individi, formateve të aksesueshme të komunikimit apo shërbimeve në komunitet në mënyrë që secili të ushtrojë të drejtat e veta në mënyrë të pavarur dhe të barabartë.

Personat me aftësi të kufizuara mendore historikisht janë përballur dhe vazhdojnë të përballen me kufizime në vendimarrje. Ata konsiderohen nga shoqëria, familjarët, miqtë, institucionet publike si persona të cilëve u mungon “kapaciteti” apo “aftësia” për të marrë vendime për jetën, shihen si persona që duhet të “mbrohen”.

Kjo qasje ndaj tyre shprehet në sistemin juridik me vendosjen në kujdestari ligjore duke i deleguar të gjithë vendimarrjen kujdestarit ligjor, i cili merr vendimet më të rëndësishme të personit nën kujdestari. Këto vendime janë nga më të ndryshmet, çështje financiare, pronësore, shëndetësore, me kë dhe ku do të jetojë personi por shpeshherë dhe vendime të tjera të jetës së përditshme.

Neni 12, i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara i njeh personat me aftësi të kufizuara para ligjit në mënyrë të barabartë pa diskriminim duke iu njohur atyre jo vetëm zotësinë juridike por edhe zotësinë për të vepruar.

Kjo e drejtë garanton dhe gëzimin e të drejtave të tjera në Konventë. Sipas Konventës, heqja e zotësisë për të vepruar e personave me aftësi të kufizuara dhe vendosja e tyre në kujdestari ligjore konsiderohet shkelje e të drejtave. Vendosja në kujdestari është e padrejtë dhe e panevojshme. Në vend të heqjes së zotësisë juridike ka alternativa të ndryshme, të cilat mund të ndihmojnë personin me aftësi të kufizuara në vendimarrjen e përditshme dhe veprimet e tij.

Neni 12, i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara deklaron: Personat me aftësi të kufizuar njihen dhe respektohen nga ligji në mënyrë të barabartë me të tjerët. Atyre nuk duhet t’i hiqet zotësia për të vepruar.

Zotësia për të vepruar nënkupton që çdo person ka zotësi të plotë e të barabartë për të pasur të drejta dhe detyrime civile brenda kufijve të caktuar me ligj. Zotësia juridike fillon me lindjen e personit gjallë dhe mbaron me vdekjen e tij. Zotësia për të vepruar nënkupton zotësinë e plotë, që i lind personit me mbushjen e moshës 18 vjeç, me veprimet e tij të fitojë të drejta dhe të marrë përsipër detyrime civile. Zotësia për të vepruar nënkupton ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve që çdo person kanë bazë të zotësisë juridike.

Kapaciteti ligjor përdoret në Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe nënkupton zotësinë juridike të një personi dhe gjithashtu zotësinë për të vepruar. Konventa *me kapacitet ligjor nënkupton zotësinë juridike dhe zotësinë për të vepruar, të dyja të marra së bashku si pjesë të pandashme të kuptimit të ‘kapaciteti ligjor’.*

“Vendimarrje e mbështetur” është një proces në të cilin mbështetësit ndihmojnë personat me problem të shëndetit mendor apo aftësi të kufizuara intelektuale në marrjen e vendimeve për jetën e tyre, shëndetin, çështjet financiare. “Vendimarrja e mbështetur” është ushtrimi i vullnetit nga një

person me aftësi të kufi zuara nëpërmjet një kompetence specifike të shtuar, që mbështet qëllimin dhe interesin e tij më të mirë, duke i mundësuar kryerjen e veprimeve për të fituar të drejta dhe për të marrë përsipër detyrime.

Çdo person me aftësi të kufizuara, që ka nevojë për ndihmë në vendimmarrje, merr mbështetjen e duhur nga një individ ose grup individësh të besuar.

Rregullat, procedurat dhe kriteret e ofrimit të këtyre shërbimeve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Shqipëria nuk ka një legjislacion në përputhje me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, pasi kodet bazë akoma, në mënyrë absolute, lejojnë vendosjen në kujdestari. Në Shqipëri personat vlerësohen bazuar mbi qasjen mjekësore për të hequr zotësinë për të vepruar

Në këtë kontekst, adresimi i sa më sipër, përkthehet në nevojën për reformë të thellë ligjore: heqjen e dispozitave që parashikojnë heqjen ose kufizimin e zotësisë juridike, ndryshimin e kuadrit në Kodin Civil, Kodin e Familjes dhe legjislacionin përkatës, dhe ndërtimin e një sistemi mbështetës funksional e të aksesueshëm, duke theksuar këtu në mënyrë të vecantë informacionin dhe komunikimin e aksesueshmë, e gjithashtu përshtatjen e arsyeshme, të cilat duhe të udhëheqin të gjitha këto ndryshime. Vetëm kështu do të garantohet që të drejtat e personave me aftësi të kufizuara të mos mbeten teorike, por të ushtrohen realisht në jetën e përditshme dhe në marrëdhëniet me ligjin dhe institucionet.

Komenti i Përgjithshëm nr. 4 (2022) mbi nenin 13 të KDPAK thekson se aksesin në drejtësi për personat me aftësi të kufizuara nuk kufizohet vetëm në hapjen formale të dyerve të gjykatës, por nënkupton pjesëmarrje të plotë, të drejtpërdrejtë dhe efektive në çdo fazë të procesit gjyqësor.

Kjo kërkon njohjen e kapacitetit juridik të barabartë për të gjithë, sigurimin e mbështetjes në vendimmarrje, ofrimin e përshtatjeve të arsyeshme procedurale dhe heqjen e barrierave që pengojnë ushtrimin e të drejtave. Personat me aftësi të kufizuara duhet të kenë mundësinë të ngrejnë padi, të mbrohen, të dëshmojnë dhe të marrin pjesë si viktimë ose palë të dëmtuara, duke u ofruar në çdo rast ndihma e nevojshme ligjore dhe komunikimi i përshtatur.

Pas ratifikimit të KDPAK Shqipëria ka miratuar një sërë ligjesh dhe vendimesh me qëllim përputhjen e legjislacionit vendas me KDPAK për të garantuar respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

Kështu, ligje të tilla si Ligji për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë dhe vendimet/aktet nënligjore të dala në zbatim të tij janë dukshëm një përpjekje për të përqasur legjislacionin Shqiptar me standardet e KDPAK-së. Megjithatë, duhet theksuar se në fushën e barazisë para ligjit, dhe në veçanti sa i përket zotësisë juridike për të vepruar, asnjë nga ndërhyrjet e propozuara nuk është e mjaftueshme për të garantuar këto standarde, për sa kohë që nuk kryhet një ndryshim i drejtpërdrejtë në Kodin Civil, Kodin Penal, Kodin të Familjes, Kodin të Procedurës Civile dhe Penale.

Kjo, në respektim të parimit të hierarkisë normative, sipas të cilit aktet ligjore të rangut më të ulët nuk mund të bien në kundërshtim me ligjet e miratuara në nivel më të lartë hierarkik.

Megjithatë ndryshimet vlejnë për t'u vlerësuar, pasi në një kontekst më shumë jo-formal ose gjysmë formal, ka tashmë hapësira për të manovruar pa nevojën për të përdorur heqjen e zotësisë për të vepruar dhe vendosja në kujdestari.

Kështu, Ligji për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë adreson vendimmarrjen e mbështetur, por në mënyrë jo të lidhur me zotësinë juridike për të vepruar. Sipas tij, “vendimmarrje e mbështetur” është ushtrimi i vullnetit nga një person me aftësi të kufizuara nëpërmjet një kompetence specifike të shtuar, që mbështet qëllimin dhe interesin e tij më të mirë, duke i mundësuar kryerjen e veprimeve për të fituar të drejta dhe për të marrë përsipër detyrime.

Çdo person me aftësi të kufizuara, që ka nevojë për një vendimmarrje, merr mbështetjen e duhur nga një individ ose grup individësh të besuar.

Mbështetja mund të sigurohet në një sërë mënyrash, përfshirë mbështetjen me anë të interpretimit dhe gjuhës së thjeshtë, duke e copëzuar informacioni në pjesë më të vogla të cilat personi mund t'i kuptojë, si dhe ndihmën në marrëdhëniet e personit me palë të treta, që nuk mund të kuptojnë mënyrat e tij të komunikimit. Mbështetja jepet gradualisht, duke u dhënë kohë të mjaftueshme personave që e kërkojnë atë, për të mësuar se si mund ta përdorin mbështetjen për më të mirën e tyre.

Pavarësisht disa aspekteve pozitive në lidhje me njohjen e barabartë para ligjit, sikurse përpjekja për të përfshirë në legjislacionin shqiptar konceptin e vendimmarrjes së mbështetur, parashikimin e formave të ndryshme të saj, si edhe parashikimin e rregullave të posaçme për ofrimin si shërbim, ligji përmban disa mospërputhshmëri me KDPAK. Kështu, fakti i parashikimit të ushtrimit të vullnetit të personit me aftësi të kufizuara përmes një kompetence të shtuar vë në pikëpyetje ushtrimin e vullnetit dhe preferencave sipas KDPAK, duke lënë interpretime për zëvendësimin e vullnetit dhe preferencave përmes kompetencës së shtuar dhe nuk ofron garanci për moslejimin e kujdestarisë ligjore apo heqjes së zotësisë për të vepruar. Sigurisht ky ligj nuk mund të ofrojë zgjidhje të tilla pa ndryshimet në kodet përkatëse, pikërisht për arsye të respektimit të parimit të hierarkisë normative të përmendur pak më lart. Ligji përcakton që rregullat, procedurat dhe kriteret e ofrimit të këtyre shërbimeve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

VKM nr. 470, datë 06.07.2022 *“Për përcaktimin e rregullave, procedurave dhe kriterëve të ofrimit të shërbimeve të vendimmarrjes së mbështetur për personat me aftësi të kufizuara”*, paraqet një sërë problematikash duke krahasuar me standardet e nenit 12 dhe të Komentit të Përgjithshëm të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Së pari, thekson që nuk zëvendëson në asnjë mënyrë alternativat ekzistuese të kujdestarisë.

Së dyti, vendimi përdor konceptin e interesit më të mirë të personit, sikurse dhe vetë Ligji për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë në përkufizimin që jep për vendimmarrjen e mbështetur.

Kjo bie në kundërshtim me nenin 12 të KDPAK- nen i cili vendos vetëm vullnetin dhe preferencat e personit me aftësi të kufizuara si kriter për mbështetjen që i jepet në vendimmarrje dhe thekson që interesi më i lartë nuk duhet të përdoret.

Nga ana tjetër, në pikën 1 përcaktohet që ofrimi i vendimmarrjes së mbështetur bazohet në respektin e nevojave, dëshirave, zgjedhjeve, vlerave, besimeve dhe traditave të personave me aftësi të kufizuara, duke krijuar një situatë të paqartë në lidhjen me përdorimin e “kritereve” për mbështetjen në vendimmarrje.

Së treti, në përshkrimin e vendimmarrjes së mbështetur vendimi i referohet përkufizimit të vendimmarrjes së mbështetur në Ligjin për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë duke përdorur togfjalëshin: kompetencë e shtuar, natyra e të cilit nuk është e qartë, duke lejuar disa nënkuptime, një prej të cilëve mund të jetë që personi me aftësi të kufizuara nuk ka zotësi për të marrë vendime prandaj nevojitet një kompetencë të shtuar, që bie në kundërshtim me nenin 12, të KDPAK.

Plani Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021–2025.

Qëllimi i politikës - Garantimi i aksesit të barabartë në sistemin e drejtësisë për të gjithë personat me aftësi të kufizuara

Barazia përpara ligjit dhe sigurimi i një qasjeje efektive në drejtësi për personat me aftësi të kufizuara, paraqiten në një kapitull të veçantë të PVKPAK 2021–2025, duke iu referuar kështu nenet 12 dhe 13, të KDPAK-ut.

Personat me aftësi të kufizuara shpesh herë përballen me vështirësi të shumta për të pasur akses të barabartë me të tjerët në sistemin e drejtësisë, gjë e cila vjen si pasojë e shumë faktorëve, siç janë: barrierat në infrastrukturë, pamundësia për të marrë informacionin e duhur, pamundësia financiare për pagesat që kërkohen etj.

Qëllimi kryesor i politikës në fushën e barazisë, bazohet në progresin që Shqipëria duhet të bëjë për të realizuar parimin respektiv të KDPAK-ut e për pasojë eliminimin e barrierave të ndryshme për të pasur akses të barabartë në sistemin e drejtësisë.

Për zbatimin e kësaj politike, institucionet shtetërore që kanë përgjegjësi në këtë fushë në partneritet me institucione dhe organizata të tjera do të fokusohen në 3 objektiva specifikë:

Objektivi specifik 1 - Rritja e numrit të individëve me aftësi të kufizuara që përdorin shërbimet e ndihmës juridike falas

Objektivi specifik 2 - Njohja e barabartë para ligjit i personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht i personave me aftësi të kufizuara mendore.

Objektivi specifik 3 - Garantimi i respektimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në institucionet e dënimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare

Objektivi specifik 2. Njohja e barabartë para ligjit i personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht i personave me aftësi të kufizuara mendore. Këtu citohet se:

“Për personat me aftësi të kufizuara në sistemin e drejtësisë kërkohen ndryshime në legjislacion për të mundësuar ushtrimin e lirive dhe zgjedhjeve individuale. Është e rëndësishme të krijohet një

mekanizëm ligjor për të mbështetur vendimmarrjen⁷, ndërkohë që mbizotëron kujdestaria ligjore. Kjo çështje është e rëndësishme si për aksesin në drejtësi, ashtu edhe për fusha të tjera të Planit të Veprimit. Administrimi i pasurisë nga një kujdestar u mohon personave me aftësi të kufizuara të drejtën për të menaxhuar pasuritë e tyre financiare dhe të drejtën e posedimit të pasurisë. Sipas nenit 33, të Kodit të Procedurës Civile, nuk mund të paraqiten padi ligjore nga një person të cilit i mungon zotësia për të vepruar. Në të njëjtën kohë, në procedurat për të hequr zotësinë e një personi për të vepruar, personi në fjalë nuk ka të drejtë të jetë palë⁸.

Kodi Civil përmban dispozita ligjore, të cilat bien ndesh me parimin e zotësisë për të vepruar dhe i referohet koncepteve të “prapambetjes mendore”, “çrregullimeve të shëndetit mendor” dhe “çrregullimeve psikike”, ndërsa Kodi i Familjes parashikon emërimin e një kujdestari në rastet e heqjes/kufizimit të zotësisë për të vepruar.”

Siç argumentohet në konkluzionet përmbyllëse të Komitetit të OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, legjislacioni shqiptar lidhur me zotësinë juridike për të vepruar, vazhdon të mbetet i vjetruar dhe duhet domosdoshmërisht të fillojnë përpjekjet për ta sjellë atë në përputhje me këndvështrimin e KDPAK-ut.

Konkretisht ky Komitet rekomandon që shteti shqiptar, duhet: “Të harmonizojë legjislacionin në përputhje me Konventën, të shfuqizojë të gjitha ligjet që kufizojnë zotësinë juridike të personave me aftësi të kufizuara, në veçanti të personave me aftësi të kufizuara psikosociale ose intelektuale, duke zëvendësuar mënyrën e vendimmarrjes së zëvendësuar me vendimmarrje të mbështetur që respektojnë autonominë, vullnetin dhe preferencat e personit”. Për të arritur të ndërhyrjet për përmirësime dhe ndryshime në Kodin Civil, Kodin e Procedurës Civile dhe Kodin e Familjes, me qëllim njohjen e zotësisë ligjore të personave me aftësi të kufizuara, proces që kërkon ndërgjegjësim, njohuri dhe dakordësim të disa institucioneve, Plani parashikon të kryejë aktivitete për ndërgjegjësimin e institucioneve përkatëse nëpërmjet trajnimeve të punonjësve lidhur me zotësinë ligjore për të vepruar të përcaktuar nga KDPAK-u, si dhe kryerjen e vlerësimeve për situatën e personave me aftësi të kufizuara në lidhje me zotësinë ligjore për të vepruar.”

IV. Konkluzione

⁷ Neni 7 i ligjit për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara e përcakton atë si: “ushtrim i vullnetit nga një person me aftësi të kufizuara përmes një kompetence specifike të shtuar që mbështet qëllimin dhe interesin e tij më të mirë, duke i mundur atij të kryejë veprime për të fituar të drejtave dhe për të marrë përsipër detyrimet”. I njëjti nen, gjithashtu, shpjegon se: “Çdo person me aftësi të kufizuara që ka nevojë për ndihmë në vendimmarrje do të marrë mbështetjen e duhur nga një individ ose grup individësh të besuar. Mbështetja mund të sigurohet në një sërë mënyrash, duke përfshirë mbështetjen përmes interpretimit në gjuhën e shenjave dhe gjuhë të thjeshtuar, si dhe duke ndihmuar personin me aftësi të kufizuara në marrëdhëniet me të tretët, të cilët nuk janë në gjendje të kuptojnë mënyrën e tij të komunikimit. Mbështetja jepet gradualisht, duke i dhënë kohën e mjaftueshme personave që e kërkojnë atë për të mësuar se si të përdorin mbështetjen për interesin e tyre më të mirë.”

⁸ Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Drejt drejtësisë: analiza e procedurave civile në gjykatat e rretheve, <http://ëëë.osce.org/albania/100388>, f. 13.

Komisioneri vlerëson se, shteti duhet t'u sigurojë mbrojtje efektive dhe barazi në trajtim të gjithë personave, në mënyrë që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëlloj si të tjerët, si dhe të trajtohen me dinjitet.

Referuar parashikimeve specifike në legjislacionin ndërkombëtar të ratifikuar nga Shqipëria, legjislacionin e brendshëm, si dhe standardet ndërkombëtare dhe kombëtare; barazia dhe mosdiskriminimi i personave, duhet kuptuar jo vetëm si barazi formale, por ajo duhet të jetë e zbatueshme, efektive dhe e prekshme për këta persona.

Materializimi i shumë të drejtave për individët, bëhet fillimisht nëpërmjet hartimit dhe miratimit të ligjeve dhe akteve nënligjore nga ana e qeverisë, e mandej nëpërmjet zbatimit efektiv në praktikë të tyre.

Në cilësinë e aktit themelor të shtetit, Kushtetuta e Shqipërisë garanton në mënyrë të barabartë të drejtën e shtetasve shqiptarë për kujdes shëndetësor nga shteti si dhe e pozicionon shtetin shqiptar drejt synimit dhe përgjegjësisë për të siguruar standardin më të lartë shëndetësor për shtetasit e tij. Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka mbajtur qëndrimin se, parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në respektim të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal të tyre, ashtu edhe atë material. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor⁹.

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara, ndërkohë që Protokollin 12-të të KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose

⁹⁹ Citojmë këtu, Vendimet e Gjykatës Kushtetuese me: nr. 2, datë 03.02.2010, nr.1, datë 12.01.2011, nr. 23, datë 08.06.2011.

nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet¹⁰.

GJEDNJ, shprehet se, ndalimi që rrjedh nga neni 14, do të krijojë detyrime positive për shtetet kontraktuese për të bërë dallimet e nevojshme ndërmjet personave ose grupeve, rrethanat e të cilëve janë në mënyrë të rëndësishme dhe domethënëse të ndryshme¹¹.

Për më tepër, GJEDNJ, shprehet se, neni 14 nuk e ndalon një shtet anëtar që t'i trajtojë grupet ndryshe për të korrigjuar “pabarazitë faktike” ndërmjet tyre; në të vërtetë, në rrethana të caktuara, dështimi në përpjekje për të korrigjuar pabarazinë nëpërmjet trajtimit të ndryshëm, mund të shkaktojë në vetvete një shkelje të nenit 14¹².

Komisioneri vlerëson se, në analizë të sa më sipër, sistemi ligjor shqiptar ende mbart dispozita që e kufizojnë ose mohojnë zotësinë juridike për të vepruar të personave me aftësi të kufizuara, duke i vendosur ata nën kujdestari ose duke ua kushtëzuar ushtrimin e të drejtave me “gjendjen mendore” apo “aftësinë për të vepruar”. Këto institute, të ngulitura në Kodin Civil, Kodin e Procedurës Civile, Kodin e Familjes, si dhe në Kodin Penal e atë të Procedurës Penale, reflektojnë një qasje paternaliste që është në kundërshtim me parimet e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Neni 12 i Konventës njeh qartë se çdo person, pavarësisht aftësisë së kufizuar, gëzon të drejtën universale për zotësi juridike në të gjitha aspektet e jetës, ndërsa neni 13 garanton akses efektiv dhe pa diskriminim në drejtësi. Në këtë kuptim, heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, ndalimi i ushtrimit të të drejtave familjare, përjashtimi nga dhënia e dëshmisë ose pezullimi i pjesëmarrjes në proceset gjyqësore për shkak të një gjendjeje shëndetësore, bien ndesh me standardet ndërkombëtare dhe krijojnë pengesa reale për barazinë para ligjit.

Komisioneri çmon se, këto ndryshime ligjore (apo nevoja për këto ndërhyrje), duhet parë jo vetëm si ndryshime teknike në ligj, por si një proces transformues i gjithë sistemit juridik dhe institucional, që synon garantimin të barazisë dhe pjesëmarrjes së plotë të personave me aftësi të kufizuara në jetën juridike dhe shoqërore të vendit.

Komisioneri vëren se, duhet pasur parasysh se ndryshimet në kodet bazë (Civil, Penal, Familjar dhe Procedural) do të kërkojnë ndryshime të tjera të ndërthurura në ligje të lidhura me to, si: Ligji për Aksesueshmërinë, legjislacioni mbi shërbimet sociale e shëndetësore, etj. Ky proces kërkon gjithashtu një periudhë tranzitore, për të menaxhuar rastet ekzistuese të kujdestarisë ligjore dhe për të përgatitur institucionet në mënyrë që kalimi drejt sistemit të mbështetjes në vendimmarrje të ndodhë pa lënë boshllëqe.

¹⁰ Shih: Molla kundër Greqisë, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; Fábíán kundër Hungarisë, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar, 1985, prg.72

¹¹ Shih: Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019

¹² Shih: Çështjen Horváth dhe Kiss kundër Hungarisë, nr. 11146/11, datë 29.01.2013, prg. 101; Çështjen Thlimmenos, cituar më lart, prg. 44; Çështjen D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke (GC), nr.57325/00, GJEDNJ 2007-IV, prg.175).

Ekzistojnë mospërputhje të legjislacionit kombëtar me standardet ndërkombëtare në fushën e aftësisë së kufizuar, konkretisht me Konventën e OKB-se "*Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara*" dhe Komentin e Përgjithshëm nr. 1 i Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara "*Njohja e barabartë para ligjit*".

Këto standarte ndërkombëtare diktojnë nevojën për reformimin e legjislacionit ekzistues që adreson çështjen e zotësisë juridike për të vepruar të personave me aftësi të kufizuara, i cili ka në bazë të tij kujdestarinë ligjore dhe vendosjen e një sistemi krejt të ri, atë të mbështetjes në vendimmarrje.

Pra, që të arrihet përputhshmëria e legjislacionit të analizuar me KDPAK, kërkohet një transformim tërësor: nga sistemi i kujdestarisë ligjore dhe kufizimeve, drejt modelit të vendimmarrjes së mbështetur. Ky model parashikon që çdo individ të marrë mbështetjen e nevojshme për të ushtruar të drejtat e tij, duke përfshirë mbështetës të zgjedhur nga vetë personi, shërbime institucionale të aksesueshme, përshtatje të arsyeshme në procedurat gjyqësore dhe mjete alternative komunikimi. Mbështetja nuk duhet të zëvendësojë vullnetin e individit, por të garantojë shprehjen dhe respektimin e tij.

Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri gjykon se, nevojitet realizimi i një vlerësimi të përputhshmërisë së kuadrit ndërkombëtar, si: Konventa për të Drejtat e Persona me Aftësi të Kufizuara, Komentet e Përgjithshme të Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Konventa Evropiane të të Drejtave të Njeriut me një sërë ligjesh dhe politikash në nivel kombëtar, si: Kodi Civil, Kodi i Familjes, Kodi i Procedurës Civile, Ligji për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë dhe vendimet përkatëse të miratuara, Ligji për Shëndetin Mendor, Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara.

Për këtë qëllim, nevojitet të krijohet një grup i posaçëm pune me ekspertë të fushës, nga institucionet shtetërore dhe ato të pavarura, përfshirë KMD dhe AP, gjyqësorin, shoqërinë civile etj, të cilët do të evidentojnë, bazuar në nivelin e përputhshmërisë, të gjithë ndërhyrjet e nevojshme në legjislacionin ekzistues dhe do hartojnë rekomandimet, bazuar në këto gjetje.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se, për adresimin e çështjes së njohjes së barabartë para ligjit në Shqipëri, ndër të tjera, kërkohen:

- vlerësimi i përputhshmërisë së gjithë legjislacionit shqiptar me legjislacionin dhe standartet ndërkombëtare;
- evidentimi i ndërhyrjeve konkrete duke renditur nga ato prioritetet, ekspertiza e shume profesionistëve të fushave të ndryshme për të përshtatur këto nevoja,
- hartimi i rekomandimeve të shumta ligjore të cilat në vetvete kërkojnë një reformim të legjislacionit ekzistues që adreson çështjen e zotësisë juridike për të vepruar të personave me aftësi të kufizuara, krijimi i një grupi pune me ekspertë të fushave të ndryshme.

Sa më sipër, me qëllim adresimin e problematikës dhe vlerësimin e rregullimin e situatës, si dhe bazuar në nenin 32, pika 1, shkronjën "f", të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

REKOMANDON:

1. Marrjen e masave nga të gjitha subjektet përgjegjëse, sipas fushës së përgjegjësisë dhe kompetencës së tyre, për hartimin e rekomandimeve për ndryshime ligjore nëpërmjet formulimit të dispozitave të reja ose shfuqizimit të atyre ekzistuese në kodet bazë (*Kodi Civil, Kodi i Procedurës Civile, Kodi i Familjes, Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale*¹³) të cilat krijojnë sistemin, i cili bazohet në kujdestarinë ligjore përmes heqjes së zotësisë për të vepruar në kundërshtim me KDPAK; në përputhje e në harmoni me Konventën e OKB-se "*Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara*" dhe Komentin e Përgjithshëm nr. 1 i Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara "*Njohja e barabartë para ligjit*".
2. Lutemi brenda 30 ditëve nga marrja dijeni, përcjelljen e informacionit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij rekomandimi apo çdo informacion tjetër që ka rëndësi lidhur me këtë çështje.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

¹³ Të ndryshuar